

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1002 Prot.

Tiranë, më 27.09 2016

**VENDIM Nr. 96, datë 14.09.2016**

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11 të datës 14.09.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të **projektit, "Zgjatimi i linjës së transmetimit 110 kV Babicë- Sarandë, për lidhjen me Nënstacionin 110/35/20 kV Oriku"**- subjekti **OST sh.a.**, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të **projektit, "Zgjatimi i linjës së transmetimit 110 kV Babicë- Sarandë, për lidhjen me Nënstacionin 110/35/20 kV Oriku"**- subjekti **OST sh.a.**, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k.
2. Subjekti OST sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për ndërtimin e **"Zgjatimit të linjës së transmetimit 110 kV Babicë- Sarandë, për lidhjen me Nënstacionin 110/35/20 kV Oriku"**, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO-FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**